

## Përse duhen burimet gjenetike të misrit?

Prof.As. Dr. Kostandin Hajkola  
QTTB Shkodër

Me masivizimin e përdorimit të Hibrideve të misrit në fillim të shekullit të kaluar u vërejt përdorim relativisht i kufizuar i germoplazmes së misrit, heqje dore nga përdorimi i popullatave lokale. Shfrytëzimi i fenomenit të heterozit, krijimi i incukt linjave elite dhe hibrideve komercial nga një numër i kufizuar popullatash mbartti fenomene të padëshiruara në praktiken e prodhimit bujqësor. Rendja kryesisht pas linjave me aftësi kombinate të lartë çoi në ngushtimin e bazës gjenetike (përdoret vetëm 5 %, Hallauer et al). Kjo dukuri dhe efektet e bashkëveprimit genotip x mjedis kanë patur pasoja deri në komprometimin e prodhimit.

Disa shembuj me poshtë në vendin tonë tregojnë se sa të renda kanë qene pasojat e rendjes vetëm pas aftësisë së lartë prodhuese.

- prekja masive nga helmintosporioza (H.Maydis, Raca T) në fillim të viteve 70-te,
- vruhu i duhanit në vitet 60-te,
- virozat në bimën e patates,
- filokserën në bimën e hardhisë
- xhuxhezimin e linjave inbrede, komponentë prindërore të hibrideve të misrit në fundin e viteve 80-te.

*Vlerat gjenetike të popullatave të misrit*

*Të dobishme:*

- Stabiliteti agronomik
- 30 % me cikël shumë të shkurtër vegetativ
- Tregues kimike të kokrrës me interes: yndyra 3-7.8 %, proteina 9-16 %, amidoni 65.0-76.0 %, lizina 0.200-0.370, triptofani 0.04-0.09, Metionina 0.100-0.160 %, Amiloza 23.8-29.7, Amilopektina 70.3-76.2 %
- Ngjyra e kokrrës e bardhe dhe struktura qelqore
- Material fillestar me interes në krijimin e pool-ve gjenetike

*Dobësitë:*

- Rrëzimi në vegetacion
- Prekja nga bloza
- Prodhimtaria e ulët
- Vështirësi në përdorimin e drejtpërdrejtë për krijimin e linjave
- Vlera të ulët të AK për linjat të krijuara me këtë material gjenetik

Metodat me te mira për te shfrytëzuar alelet e favorshme te këtyre popullatave janë : seleksionimi rikurent (ne vijimësi), krijimi i pool-ve sintetike gërshetuar me metodën e rikryqëzimeve.

Mendoj se menaxhimi, ruajtja dhe përdorimi i burimeve gjenetike te misrit është kompleks dhe i vështire, pastaj ka edhe një kosto te larte. Ka ardhur koha te aplikojmë skema te reja ruajtjeje. Teknika e “Core collection” mund te ishte një zgjidhje racionale ne problematiken e menaxhimit e te konservimit te burimeve gjenetike. Shembuj te shumte ka nga institucione te ndryshme ndërkombëtare ne bime si bishtajoret, *fasulja*, graminacet, elbi, misri etj.

“Core collection” (bërthama baze) është afërsisht si krijimi i pool-ve gjenetike: grupime te afërta gjenetikisht te ekotipeve dhe popullatave ne një. Me ketë praktike reduktohet numri i aksesioneve ne ruajtje, por arrijmë te konservojmë pothuajse plotësisht variabilitetin gjenetik brenda dhe ndërmjet popullatave lokale. Kriteret ne krijimin e “Core Collection”-it te misrit janë: afërsia gjenetike e aksesioneve (distanca gjenetike). Për këtë i paraprijnë *tiparet* agromorfologjike, aftësia kombineve, analiza me marker molekular.

Besoj se tashme ka ardhur koha për te pare mundësinë e aplikimit te rigjenerimeve “on farm”, ne funksion te *ruajtjes se origjinalitetit*, *Ruajtjes se variabilitetit gjenetik*, *përftim te materialit gjenetik për konservim*, studim dhe shkëmbim.

*Përveç kësaj një pjese e këtyre resurseve kane interesin ekonomik te përdorimit direkt te tyre si material mbjellës e prodhues ne procesin e zhvillimit te komuniteteve specifike rurale ne funksion te turizmit dhe te ushqyerit ekologjik.*

%